

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202300962/1

Tiranë ___/___/2023

Lënda: *Rekomandime për inspektimin e bërë në Komisariatin e Policisë Malësinë e Madhe.*

Drejtuar: **Z. Muhamet RRUMBULLAKU**
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit

TIRANË

Z. Edmond SULAJ
Drejtor i Drejtorisë Vendorë të Policisë

SHKODËR

Z. Florent SULÇE
Shef i Komisarariatit të Policisë Malësi e Madhe

KOPLIK

Për dijëni: **Z. Taulant BALLA**
Ministër i Brendshëm

TIRANË

Të nderuar,

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm dhe duke vlerësuar angazhimin dhe punën e të gjithë stafit të institucionit që ju drejtoni, si dhe frymën e mirë të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis institucioneve tona, në vijim po ju njohim mbi monitorimin që institucioni i Avokatit të Popullit kreu në Komisariatin e Policisë Malësi e Madhe në datë 26.10.2023.

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, seksion pranë Avokatit të Popullit, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe nenin 81 të ligjit nr. 81/2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve".

Inspektimi u krye sipas një Plani Vjetor Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Nertila Qafzezi dhe znj. Gloria Çarkaxhiu me detyrë Nd/Komisionere pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019 për miratimin e procedurës standarde “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*” dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i vitit të kaluar, ka detyrimin ligjor t’ju parashtojë konkluzionet përfundimtare, që do të gjeni më poshtë:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të cilëve ju është privuar liria, grupi i punës u takua me Shefin e Komisarariatit të Policisë të Malësisë së Madhe z. Florent Sulçe i cili u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Në vijim, Shefi i Komisarariatit raportoi për grupin e inspektimit, mbi masat e marra për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Institucioni i Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm, në lidhje me masat e marra për përmirësimin e ambientit të shoqërimit, sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në procedurat standarde dhe aktet ndërkombëtare për këtë qëllim.

Grupi punës inspektoi ambientet e shoqërimit, u njoh me regjistrat dhe dokumentacionin ku pasqyrohen të dhënat dhe veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar, si dhe vizitoi zyrat e punës të punonjësve të policisë të këtij komisarati.

Nga informacioni i drejtuesit të komisarariatit, si dhe nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm¹, rezultoi se:

¹ Rekomandimi i dërguar me nr. K4/I25-2 prot, datë 27.07.2022.

1. Nuk ishin marrë masat për rikonstrukcionin dhe realizimin e investimeve në Komisarariat e Policisë Malësi e Madhe.
2. Nuk ishin marrë masat për ndërtimin e dhomave të shoqërimit në Komisarariat e Policisë Pukë, sipas kriterëve të parashikuara në Kreun VI, pika 4 të procedurave standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit duke përfshirë në të, ndërtimin e ambienteve të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orëditë e nevojshme për qëndrim të ndara më vete për femra, meshkuj dhe të mitur në konflikt me ligjin.
3. Nuk ishin marrë masat për pajisjen e Komisarariatit Malësi e Madhe me *“Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar”* sipas tipit *“Model nr.1”*, konform procedurave standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit në polici”*, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
4. Nuk ishin marrë masat për pajisjen e komisarariatit me një regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 *“Për Policinë e Shtetit”*, i ndryshuar.
5. Nuk ishin marrë masat e nevojshme për krijimin e zyrave ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra.
6. Nuk ishin marrë masa për krijimin e zyrave të posaçme për intervistim me persona të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me të miturit.
7. Nuk ishin marrë masa për sigurimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjen e pajisjeve elektrike në dhomën e shoqërimit, për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit.
8. Nuk ishin marrë masa për trajnimin e punonjësve pasi nga kontrolli u evidentuan mangësi në kuptimin e detyrimeve të tyre procedurale.

Ndërkohë ishin realizuar rekomandimet si më poshtë:

- ✓ Ishin marrë masat për vënien në funksion të dhomës së shoqërimit me vendosjen e xhamave në dritaren e dhomës të shoqërimit, lysterjen e dezinfektimit, si dhe kompletimin e saj me orenditë e nevojshme si tavolina dhe karrige për të mundësuar qëndrimin ulur të personave të shoqëruar.
- ✓ Ishin marrë masat për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhguese në ambientin e dhomës të shoqërimit në Komisarlatin e Policisë Malësi e Madhe.
- ✓ Ishin marrë masat për të vendosur postera me të drejtat dhe kartën e të drejtave të personave që shoqërohen apo ndalohen në ambientet e komisarlatit, në vende që të jenë të aksesueshëm nga këta persona.
- ✓ Ishin marrë masat për dhënien e kartës së të drejtave personave të shoqëruar apo ndaluar në momentin e hyrjes së tyre në komisarlat².

Avokati i Popullit shpreh keqardhjen se ndërsa disa nga rekomandimet kanë implikim buxhetore që nuk varen nga drejtuesit e komisarlatit, vërejmë se disa të tjera lidhen me qasjen bashkëpunuese të drejtuesve ndaj rekomandimeve, ndonëse të pranuar dhe të përsëritura.

Grupi i punës në vijim inspektoi ambientet e shoqërimit, të gjitha zyrat e punës të punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar.

Nga këqyrja e dhomave të zyrave të oficerëve të policisë **gjqësore u gjetën brenda dollapëve ose sipër tyre sende prania e të cilave të ekspozonte dhunë psikologjike/fizike tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale.**

Ajo çka evidentohet nga inspektimi i Avokatit të Popullit në komisarlat edhe mbas vizitës së CPT nuk janë marrë masa për heqjen e sendeve nga zyrat e oficerëve të policisë gjyqësore.

Në këtë Komisarlat mungonte një dhomë e cila të ishte magazinë për administrimin dhe ruajtjen e provave materiale ashtu siç parashikohet dhe në procedurën standarde për këtë qëllim.

Mbajtja e këtyre sendeve në dhomat e oficerëve të policisë gjyqësore **përbën shkelje të rregullave dhe procedurave të punës për administrimin e provave materiale** të fiksuara gjatë procedimeve penale, duke i mbajtur ato në zyrat e punës të pa paketuara/ambalazuara apo futur në qese për këtë qëllim në komisarlatin e policisë Malësi e Madhe.

² Kthim përgjigje nga Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër, nr.7343/1prot dt.25.08.2022 në të cilën evidentohet se vazhdon puna për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Avokati i Popullit.

Mekanizmi kombëtar përgjatë inspektimit u informua se në këtë komisariat ka inspektuar/vizituar ambientet e tij dhe Delegacioni për Parandalimin e Torturës (CPT) të KIE, në kuadër të vizitës së 7 periodike nga data 04-15 Maj 2023. Në përfundim të vizitës CPT ka hartuar raportin me vëzhgimet dhe konkluzionet paraprake të cilat i ka përcjellë zyrtarisht nëpërmjet Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Në këtë raport janë bërë prezent mangësitë dhe problematikat e konstatuara në Komisarlatin Koplík (Malësi e Madhe) si më poshtë:

Në komisarlatin e Policisë Malësi e Madhe, specialistë të strukturave për hetimin e krimeve, ushtrojnë dhunë fizike duke goditur me shkop druri në pjesë të ndryshme të trupit personat e arrestuar/ndaluar (përfshi dhe shputat e këmbëve). Për rastin në fjalë, personi i arrestuar që gjendej në paraburgim (në IEVP) i ka përshkruar delegacionit në mënyrë të detajuar ambientin/ zyrën e policisë në këtë komisariat dhe vendin ku ndodhej shkopi i drurit me të cilin ishte dhunuar, i cili pas kontrollit është gjetur saktësisht në vendin ku është përshkruar nga delegacioni.

Avokati i Popullit shpreh shqetësimin e thellë se nuk ka asnjë angazhim nga Drejtuesit e Strukturave të Policisë së Shtetit për adresimin e kësaj problematike dhe zgjidhjen e saj, e konstatuar edhe më herët gjatë muajit maj 2023 nga vizita e Delegacionit të CPT.

Nga informacioni i grumbulluar në vend gjatë kryerjes së inspektimit, rezultoi se gjendja konkrete e ambienteve të shoqërimit ishte e ngjashme si në inspektimin pararendës, ballafaquar me standardet e parashikuara në aktet normative dhe dokumentet ndërkombëtare, për respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar brenda këtyre ambienteve.

Gjithashtu u vu re se Komisarlati i Policisë Malësi e Madhe është i përqendruar në një godinë të vjetër ekzistuese e cila është shumë e amortizuar dhe nuk ofron kushte të denja pune edhe për punonjësit e këtij institucioni çka kërkon domosdoshmërisht realizimin e investimeve për rikonstruksionin e saj në vijim.

Në përfundim të inspektimit grupi monitorues në Komisarlatin e Policisë Malësi e Madhe, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika dhe më konkretisht:

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Në Komisarlatin e Policisë Malësi e Madhe ambientet e shoqërimit nuk ishin realizuar plotësisht sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë

e Shtetit”³, i ndryshuar dhe procedurës standarde dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, ku parashikohet se dhomat e shoqërimit duhet të jenë me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për gratë, meshkujt madhorë dhe të miturit.⁴

Në Komisarlatin e Policisë Malësi e Madhe ambientet e shoqërimit ishin përshtatur duke shfrytëzuar si dhomë shoqërimi vetëm një nga ambientet ekzistuese të godinës për meshkujt madhorë ndërsa gratë dhe të miturit mbaheshin në dhomat e oficerëve të policisë.

Në këtë Komisarlat sërish kishte vetëm një dhomë shoqërimi, e cila ndodhej në katin e parë të ndërtesës së Komisarlatit. Dhoma ishte me përmasa 4 x 2m, me dritare e cila lejonte ajrim dhe ndriçim natyral, dhoma kishte ndriçim nga rrjeti elektrik. Ajo ishte e pastër dhe e lyer rishtazi dhe ishte e pajisur me orenditë e nevojshme, si tavolinë dhe karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar madhorë meshkuj. Dhoma e shoqërimit nuk kishte sistem ngrohjeje kryesisht për periudhën e dimrit.

Nga drejtuesi i këtij Komisarlati na u bë me dije se personat e shoqëruar mbaheshin në zyrat e punës deri sa mbaronin procedurat e verifikimit dhe të pyetjes së tyre dhe në vijim ata dërgoheshin në Komisarlatin e Policisë Shkodër. Në rastet kur në Komisarlat shoqëroheshin gra dhe të mitur ndiqej e njëjta procedurë. Ndërkohë që tualeti ndodhej në katin e sipërm dhe përdorej si nga të shoqëruarit ashtu edhe nga administrata, e cila është në kundërshtim me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shteti, në të cilën përcaktohet se: e. Ambientet e dhomave të shoqërimit projektohen dhe ndërtohen sipas normave dhe parametrave teknikë dhe higjienikë të mëposhtëm:

e.1 Në njësitë vendore policore ndërtohen ambientet e shoqërimit të ndara më vete për personat madhorë, të mitur dhe femra, të cilat kanë sipërfaqe nga 16-20 m² secila;

e.2 Pranë dhomave të shoqërimit dhe ngjitur me to ndërtohen dhe funksionojnë tualetet për kryerje të nevojave personale të ndara për femra dhe meshkuj, me

³ Nuk plotësoheshin kushtet si vijon: Mjediset/ambientet të jenë të ndara më vete për persona të rritur, gra dhe të mitur. Këto mjedise të jenë brenda ndërtesave të drejtorive, komisarlateve dhe stacioneve të policisë. Mjediset të jenë me sipërfaqe dhe hapësirë të bollshme për qëndrimin e personave të jenë të lyera, të pastra nga higjienike si dhe të kenë dritare me përmasa të tilla që të krijojnë mundësi për realizimin e ajrimit e ndriçimit të plotë natyral. Në mjediset ku pyetet i shoqëruari të kenë të vendosura pajisje e orendi pune për specialistët e ndihmës specialistët e policisë si; tavolina e karrige si dhe stola për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar, të cilat të jenë të fiksuara dhe të pa lëvizshme. Brenda këtyre ambienteve ose ngjitur me to, të ketë tualete, të ndara për gra dhe meshkuj, të pajisur me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim.

⁴ Pika 4 e procedurës standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”. e.1 Në njësitë vendore policore ndërtohen ambientet e shoqërimit të ndara më vete për personat madhorë, të mitur dhe femra, të cilat kanë sipërfaqe nga 16-20 m² secila.

sipërfaqe të mjaftueshme për vendosjen e pajisjeve përkatëse dhe funksionimin për qëllimin që kanë, me sipërfaqe 6 – 8 m².

Në korridorin e ambientit të shoqërimit dhe brenda dhomës ishte instaluar sistem monitorimi me kamera për vëzhgimin e veprimeve që kryheshin me të shoqëruarit. Në kohën e kryerjes së inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar.

Gjithashtu nga këqyrja e të gjitha ambienteve të komisariatit u konstatua se asnjë nga zyrat e punës së administratës si dhe dhoma e shoqërimit nuk ishin të emërtuara mbi funksionin e tyre, përgjatë inspektimit dhe këqyrjes të këtyre dhomave ishte e pa qartë se cilat ishin zyrat e punës së gjithsecilit nga punonjësit e administratës së Komisarariatit Malësi e Madhe.

Ndërsa për periudhën Janar – Tetor 2023 në regjistër ishin evidentuar të dhënat për 82 persona të shoqëruar në mjediset e këtij komisariati.

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre

Në Komisariatin e Policisë Malësi e Madhe nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Shkodër.

Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar si dhe trajtimi i të shoqëruarve, ndaluarve/arrestuarve gjatë veprimeve që kryen policia

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisariatin e Policisë Malësi e Madhe, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” **nuk** ishte i tipit “Model nr. 1” Procedura Standarde e punës “ *Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë* ”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Urdhër: nr. 894 dt. 19.07.2022. Personat e shoqëruar regjistroheshin në një regjistër me format të ndryshëm nga ai i miratuar në aktin e mësipërm, **saktësisht në disa fletë të kapura A4, të cilat janë në kundërshtim me urdhrat në fuqi dhe cenojnë rëndë garancitë e respektimit të të drejtave të personave të shoqëruar.**

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar **regjistroheshin në këto fletë** nga punonjësit e zyrës së informacionit. Në pikën VIII të procedurës standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”, thuhet se: “Akti/veprimi i shoqërimit, detyrimisht evidentohet dhe dokumentohet në sistemin elektronik, në regjistra, në formularë dhe proceverbale”. Procedurat e evidentimit të veprimeve që janë kryer me të shoqëruarin kryhen nga punonjësi i policisë që ka

punuar dhe sqaruar çështjen, ndërsa hedhja e të dhënave në regjistër dhe në sistemin elektronik të të dhënave kryhet nga punonjësit i policisë të shërbimit të informacionit në njësinë policore. Moszbatimi i kësaj kërkesë nga personat përgjegjës për dokumentimin e aktit të shoqërimit, përbën **shkelje të rëndë disiplinore**.

Gjithashtu, në këtë Komisarariat administrohej regjistër për të miturit të shoqëruar në konflikt me ligjin ku evidentoheshin të gjithë rastet e të miturve të shoqëruar në këto ambiente, nga këqyrja e këtij regjistri u konstatua **se nuk ishte i plotësuar dhe evidentuar sipas rubrikave të dhënat për të miturit në konflikt me ligjin**.

Ndërkohë u konstatua se në këtë Komisarariat **nuk kishte** edhe regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, dhe për pasojë ishte e pamundur të evidentoheshin kërkesat apo ankesat e personave të shoqëruar në këtë Komisarariat.

Ambientet e intervistimit

Në Komisariatin e Policisë Malësi e Madhe oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e punës së tyre. Këto zyra nuk ishin të monitoruara dhe ndërkohë në këtë organ nuk kishte ambiente të veçanta intervistimi të monitoruara me kamera gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.

Lidhur me këto fakte Avokati i Popullit nisur edhe nga inspektimi i mëparshëm ka rekomanduar marrjen e masave për krijimin e zyrave të dedikuara ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra por është konstatuar se sërish ky i fundit nuk është plotësuar⁵. Procesi i monitorimit filmik gjatë marrjes në pyetje të personave të shoqëruar është një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve apo arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit

⁵ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standarteve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohej që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” Raporti i CPT-së për Armeninë: CPT/Inf (2016) 31 [par.20]

Drejtoria e Policisë së Shtetit i ka dërguar Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër nëpërmjet shkresës, Nr.5108/2Prot, dt 14.06.2023 me lëndë: “Për njohjen dhe zbatimin e konkluzioneve paraprake të Komitetit për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve Çnjerëzore (CPT) të KIE-së”. Në këtë shkresë kërkohet nga strukturat drejtuese të Policisë analizimi i situatës dhe marrjen e masave për eliminimin e shkeljeve/mangësive.

Ndihma juridike dhe psikologjike

Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat sipas një liste që disponohej në institucion.

Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë. Ndërsa psikologu sigurohej në bashkëpunim me shkollat e mesme të qytetit të Koplikut.

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e godinës, si dhe në dhomën e shoqërimit të këtij komisariati ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar.

U konstatua se në këtë komisarjat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Grupi i inspektimit të Avokatit të Popullit këqyri disa praktika të njëpasnjëshme ku në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë në Komisarjat e Policisë Malësi e Madhe, **u konstatua se “Procesverbalet e Shoqërimit”, ishin të paplotësuara në rubrikat e tij dhe të pa nënshkruara nga oficeri i policisë gjyqësore që ka kryer veprimet dhe mungon nënshkrimi i personit të shoqëruar.** Sa më sipër është një shkelje e rëndë e procedurave të punës.

Në procedurën Standarde të punës “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, përcaktohet qartë në kreun VII, pikat a.2.1 – Formulari i raportit të Shoqërimit plotësohet nga punonjësi i policisë

që ka kryer shoqërimin e personit, menjëherë pas shoqërimit të personit në ambientet e policisë/ambientet e shoqërimit.

a.2.2 – Formulari i raportit të Shoqërimit plotësohet në dy kopje dhe pasi plotësohet sipas kërkesave dhe rubrikave të parashikuara në të, i dorëzohet punonjësit të shërbimit të informacionit, i cili e kontrollon për saktësinë dhe korrektësinë e plotësimit

a.2.3 – Nëse nga punonjësi i shërbimit të informacionit konstatohen parregullsi në plotësim ja kthen punonjësit të policisë për ta ri plotësuar dhe njëkohësisht vë në dijen i eprorin e drejtpërdrejtë të punonjësit të policisë.

a.2.4 – Një kopje e Formularit të Raportit të Shoqërimit i jepet punonjësit të policisë që ngarkohet për të sqaruar e trajtuar arsyen/shkakun e shoqërimit dhe zgjedhjen e çështjes për personin e shoqëruar dhe kopja tjetër administrohet nga punonjësi i shërbimit të informacionit i cili në fund të çdo jave i dorëzon në sekretari/arshivën e njësisë policore.

Gjithashtu, grupi inspektimit u informua se personat e shoqëruar/ndaluar njihen verbalisht me të drejtat e tyre që nga fillimi i privimit të lirisë, karta e të drejtave i jepet çdo personi të shoqëruar/ndaluar, që në momentin e hyrjes në ambientet e Komisarariatit për të garantuar njohjen e të drejtave që nga fillimi i privimit të lirisë si një detyrim ky i cili i është ngarkuar edhe nga Komiteti për Parandalimin e Torturës i Këshillit të Evropës⁶. Ky veprim vjen në përputhje edhe me parashikimin në nenin 28 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*” dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt.04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit për nxjerrjen e përgjegjësive dhe dhënien e masave disiplinore për punonjësit e policisë të Komisarariatit Malësi e Madhe të cilët të cilët janë konstatuar nga

⁶ KPT u bën thirrje autoriteteve shqiptare të ndërmarrin hapa për të siguruar që personat e ndaluar nga policia të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre që nga fillimi i heqjes së lirisë (d.m.th., që nga momenti kur ata janë të detyruar të qëndrojnë në polici). Kjo duhet të sigurohet me ofrimin e informacionit të qartë verbal që në fillim, i cili do të plotësohet sa më parë (pra menjëherë pas mbërritjes në ambientet e policisë) duke siguruar Kartën e të Drejtave të sipërpërmendur. Personave në fjalë duhet t'u kërkohe të nënshkruajnë një deklaratë që vërteton se kanë marrë një kopje të Kartës së të Drejtave.
Konsulto: <https://rm.coe.int/168097986b>

Avokati i Popullit se kanë një neglizhencë të theksuar lidhur me respektimin e të drejtave për personat e shoqëruar lidhur me:

- a) Në zyrat e punës të oficerëve të policisë gjyqësore, gjenden brenda dollapëve ose sipër tyre sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë psikologjike/fizike tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale.
 - b) Mungon regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar (*Lidhja Model nr. 1*).
 - c) Regjistri i të miturve i paplotësuar, nuk ishte i plotësuar dhe evidentuar sipas rubrikave të dhënat për të miturit në konflikt me ligjin.
 - d) Procesverbalet e Shoqërimit, të paplotësuar në rubrikat e tij dhe të pa nënshkruar nga oficeri i policisë gjyqësore që ka kryer veprimet dhe mungon firma e personit të shoqëruar.
2. Marrjen e masave të nevojshme, për ndërtimin e dhomave të shoqërimit në Komisarariatit të Policisë Malësi e Madhe, sipas kritereve të parashikuara në Kreun VI, pika 4 të procedurës standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit duke përfshirë në të, ndërtimin e ambienteve të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orënditë e nevojshme për qëndrim të ndara më vete për femra, meshkuj dhe të mitur në konflikt me ligjin.
 3. Marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen e komisarariatit Malësi e Madhe me “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” sipas tipit “Model nr.1”, konform procedurave standarde.
 4. Marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen e komisarariatit me një regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar.
 5. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrave ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra.
 6. Marrjen e masave për ndërtimin e tualetit ngjitur me dhomën e shoqërimit për kryerje të nevojave personale të ndara për femra dhe meshkuj, me sipërfaqe të mjaftueshme për vendosjen e pajisjeve përkatëse dhe funksionimin për qëllimin që kanë, me sipërfaqe 6 – 8 m².

7. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrave të posaçme për intervistim me persona të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me të miturit.
8. Marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjen e pajisjeve elektrike në dhomën e shoqërimit, për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit.
9. Trajnim të punonjësve të policisë që shërbejnë në zyrën e Informacionit në komisariatit e policisë Malësi e Madhe pasi nga kontrolli u evidentuan mangësi në kuptimin e detyrimeve të tyre procedurale.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONER

Ahmet PRENÇI